



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMLORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2024:009888

Datë: 20.03.2024

Numri i dokumentit: 05481467

Nr. i lëndës në Ndërmjetësim 498/2024

C.nr.779/2023

GJYKATA THEMLORE MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Avdulla Mecinaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit M.X., të cilën e përfaqëson me autorizim av. Q.R. nga Skenderaj dhe e paditura Komuna Skenderaj - Drejtoria e Arsimit, me adresë në Rr."28 Nëntori", në Skenderaj të cilën e përfaqëson përfaqësuesi E.Ç. nga Skenderaj, për kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë, duke vendosur sipas marrëveshjes së palëve të arritura nga ndërmjetësuesi N.O. ndërmjetësues i licencuar, bazuar në nenin 15 paragrafit 4 të Ligjit nr.06/L-009 për Ndërmjetësim dhe pas vlerësimit të marrëveshjes të dt:06.03.2024 të palëve të arritura në ndërmjetësim, me dt.20.03.2024, jep këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET Marrëveshja e arritura në procedurën e ndërmjetësimit në lëndën C.nr.779/2023, me dt.06.03.2024.

II. Marrëveshja e arritura në ndërmjetësim e fiton fuqinë e vendimit të formës së prerë dhe dokumentit përmbarues sipas dispozitave ligjore në fuqi përfshirë këtu edhe dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

III. Vendimi iu dorëzohet palëve dhe kundër të njëjtit, sikurse edhe kundër marrëveshjes së arritura, palët nuk kanë të drejtë ankese.

IV. Prishjen apo anulimin e marrëveshjes së arritura në ndërmjetësim, palët kanë të drejtë ta kërkojnë vetëm me padi të veçantë në procedurë të veçantë gjyqësore.

Gjyqtari

Avdulla Mecinaj